

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6564
E hënë, 21 mars 2022
çmimi 0.40

651 raste aktive
me Covid-19 | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FATURA E MUAJIT MARS ME TARIFA TË REJA, KESCO SHPJEGON
SI DO TË LLOGARITET ÇMIMI | FAQE 4-5

FATURA E RRYMËS ME TARIFA TË REJA



Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) ka njoftuar se në bazë të vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji faturat e muajit mars do të njehsohen plotësisht me tarifa të reja. Sipas KESCO-s, konsumi do të ndahet në dy blloqe, 0-800kWh dhe më i lartë se 800kWh dhe në dy intervale ditore, përkatësisht ditë e natë

AKTUALE



DIPLOMOJNË LIDERËT
E RINJ NGA KONTINGJENTI I
NËNOFICERËVE TË FSK-së F. 6

PËRKUJTOHEN MARTIRËT E LAGJES
II TË QYTETIT TË SKENDERAJT F. 3

LATIFI: KOSOVËS I DUHET
FUNKSIONALIZIMI I QENDRËS SË
TRAUMËS DHE EMERGJENCAVE F. 3

EKONOMI



PËR NJË METËR KATROR DERI
NË 200 EURO MË SHTRENJTË
BANESAT NË KOSOVË F. 7

TËRHEQJA E KURSIMEVE
PENSIONALE, TRUSTI: NE KRYEJMË
PËRGJEGJËSITË TONA LIGJORE F. 7

KULTURË



TRASHËGIMIA KULTURORE,
DREJT SHKATËRRIMIT F. 10

Zelensky i gatshëm të negociojë me Putinin

FAQE 3



AVOKATI I THAÇIT, GREGORY KEHOE:
GJATË PUNËS TIME 30-VJEÇARE
NUK KAM PARË KAQ SHUMË
REDAKTIME NË DOKUMENTE

FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky i gatshëm të negociojë me Putinin

KIEV, 20 MARS - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky i ka thënë CNN-in të dielën se është i gatshëm të negociojë me presidentin rus Vladimir Putin, por ka paralajmëruar se nëse përpjekja për të negociuar dështon, kjo mund të nënkuptojë se një luftë midis dy vendeve mund të çojë në një "luftë të tretë botërore". "Jam i gatshëm të negocioj me të. Unë kam qenë i gatshëm në dy vjetët e fundit. Mendoj se nuk mund ta përfundojmë këtë luftë pa negociatë", ka thënë Zelensky.

Ai ka theksuar se "nëse ekziston vetëm një për qind e shansit që ta ndalojmë këtë luftë, mendoj se duhet ta shfrytëzojmë këtë mundësi".

Zelensky ka bërë me dije se "forcat ruse erdhën për të na shfarosur, për të na vrarë". "Dhe mund të tregojmë se populli ynë është i dinjitoz dhe se ushtria jonë është në gjendje të japë një goditje të fortë, se është në gjendje të kundërpërgjigjet. Por,

shpresonte për një armëpushim, nëse të dyja palët nuk tërhiqen nga përparimi i arritur deri më tani.

Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt dhe presidenti rus Vladimir Putin e ka quajtur "operacion të posaçëm ushtarak" që, siç ka thënë, ka për qëllim çarmatimin e Ukrainës dhe pastrimin e shtetit nga "nacionalistët e rrezikshëm". Por, Perëndimi dhe Ukraina kanë thënë se Putini ka nisur një luftë të paprovokuar.

Ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, dhe ai rus, Sergei Lavrov, janë takuar në Antali të Turqisë më herët gjatë këtij muaji. Por, diskutimet nuk kanë dhënë ende ndonjë rezultat konkret. Por, Cavusoglu, që kishte qenë i pranishëm në bisedimet mes kryediplomatëve rusë dhe ukrainas, ka thënë për të përditshmen turke "Hurriyet" se ka pasur "afirm të pozicioneve të të dyja palëve për tema të rëndësishme, për tema



për "neo-nazistë" kur i referohet lidhshimit ukrainas të zgjedhur në mënyrë demokratike. Kalin ka thënë se referenca të tilla janë fyese për Kievin.

Kievi dhe Moska kanë raportuar se kanë arritur përparim gjatë bisedimeve javën e kaluar lidhur me formulën që do ta garantonte sigurinë e Ukrainës, duke mbajtur jashtë NATO-n.

Kalin ka thënë se një marrëveshje e përhershme armëpushimi mund të arrihet vetëm në një takim midis Putinit dhe presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky. Por, ai ka thënë se Putini mendon se pozicionet në "çështjet strategjike" për Krimenë dhe Donbasin nuk janë aq të përafuara sa të mbahet një takim.

Rusia e ka aneksuar më 2014 Gadishullin ukrainas të Krimesë dhe ka mbështetur separatistët në lindje të Ukrainës, në luftën kundër forcave ukrainase.

Turqia, që ndan kufi detar me Ukrainën dhe Rusinë, ka raporte

të mira me dy shtetet dhe po tenton t'i ndërmjetësojë bisedimet e paqes.

Turqia ka shprehur mbështetjen për Ukrainën, por ka refuzuar t'i aplikojë sanksionet e Perëndimit ndaj Moskës.

OKB: Dhjetë milionë ukrainas janë larguar nga shtëpitë e tyre

Dhjetë milionë persona, mbi çereku i popullsisë, tashmë janë larguar nga shtëpitë e tyre në Ukrainë për shkak të luftës "shkatërruese" të Rusisë, ka treguar shefi i Agjencisë për Refugjatë në Kombet e Bashkuara. "Në mesin e përgjegjësive të atyre që nxisin luftëra kudo në botë, është dhimbja e shkatërruar ndaj civilëve të cilët detyrohen të largohen nga shtëpitë e tyre", ka thënë shefi i UNHCR-së, Filippo Grandi. "Lufta në Ukrainë është aq shkatërruese sa që dhjetë milionë persona janë zhvendosur brenda vendit, apo

si refugjatë jashtë Ukrainës", ka thënë ai.

UNHCR ka njoftuar se 3 389 044 ukrainas janë larguar nga shteti që prej nisjes së pushtimit rus të Ukrainës më 24 shkurt. Ndërkaq, 60 352 persona vetëm të shtunën janë larguar nga vendi.

Afër 90 për qind e atyre që kanë ikur janë gra dhe fëmijë. Burrat ukrainas nga mosha 18 deri në 60 vjeç nuk mund të largohen nga shteti pas mobilizimit të përgjithshëm ushtarak.

Sipas agjencisë së OKB-së për refugjatë, mbi 1.5 milion e refugjatëve janë fëmijë, teksa kjo agjenci ka paralajmëruar se rreziku nga trafikimi i qenieve njerëzore është "real".

Mbi gjashtë milionë persona besohet se janë të zhvendosur brenda Ukrainës.

Para konfliktit Ukraina kishte një popullsi prej 37 milionë banorësh, pa llogaritur popullsinë në Gadishullin e aneksuar të Krimesë dhe në dy rajonet lindore separatiste.



për fat të keq, dinjiteti ynë nuk do t'i shpëtojë jetët. Pra, mendoj se duhet të shfrytëzojmë çfarëdo formati, çdo shans për negociatë, mundësinë për të biseduar me Putinin. Por nëse këto përpjekje dështojnë, do të thotë se kjo është lufta e tretë botërore", ka thënë ai për CNN-in.

Turqia: Ukraina dhe Rusia janë afër marrëveshjes për çështjet "kritike"

Ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu, ka thënë më 20 mars se Ukraina dhe Rusia janë pranë arritjes së një marrëveshjeje për çështje "kritike" dhe ka shtuar se

kritike". "Ne mund të themi se kemi shpresë për një armëpushim, nëse të dyja palët nuk bëjnë hapa prapa nga pozicionet aktuale", ka thënë ai, pa dhënë hollësi për cilat çështje bëhet fjalë.

Ndërkaq, zëdhënësi i Presidencës turke, Ibrahim Kalin, ka thënë për televizionin "Al Jazeera" se të dyja palët kanë përafuar qëndrimet në katër çështje kyçe. Ai ka përmendur kërkesat ruse për Ukrainën që janë për të hequr dorë nga ambicet për anëtarësim në NATO, çmilitarizimi, atë që Rusia e ka quajtur "denazifikim" dhe mbrojtjen e gjuhës ruse në Ukrainë.

Ukraina dhe Perëndimi kanë hedhur poshtë referencat ruse



Përkujtohen martirët dhe dëshmorët e Lagjes II të qytetit të Skenderajt

SKENDERAJ, 20 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, së bashku me familjarë e bashkëqytetarë, kanë përkujtuar martirët e Lagjes II të qytetit të Skenderajt, të cilët 23 vjet më parë u vranë vetëm se ishin shqiptarë. “Sot e kësaj dite nuk ka gjykim apo dënim për ata që kryen këto krime. Lavdi martirëve të lirisë!”, ka shkruar Nura në llogarinë e vet në “Facebook”. Edhe ish-kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka përkujtuar këta martirë. “Sot me nderime dhe krenari kujtojmë e nderojmë dëshmorët e martirët e lagjeve të

Skenderajt të rënë më 20 mars 1999. Atëkohë, pas tërheqjes së vëzhguesve ndërkombëtarë të misionit të OSBE-së, kriminelet serbë, të veshur me rroba të bardha e maska të zeza, kishin filluar në Skenderaj plaçkitjet e maltretimet e qytetarëve, duke i ndarë më pas edhe burrat nga gratë, të cilët i kishin dërguar te pishat dhe atje i kishin ekzekutuar, disa prej tyre i kishin vranë në shtëpi e disa tjerë i kishin arrestuar. Rënia e tyre në altarin e lirisë është dëshmi e gjenocidit që ka bërë shteti serb në Kosovë”, ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në “Facebook”.



Latifi: Kosovës i duhet funksionalizimi i Qendrës së Traumës dhe Emergjencave

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, mori pjesë në seminarin e organizuar nga Shoqata e Ortopedëve të Kosovës, në të cilën temë diskutimi ishte “Evaluimi dhe studimi i rasteve të rralla në ortopedi”. Në fjalimin e tij para të pranishmëve në këtë seminar, ministri Latifi theks të veçantë u kushtoi shtatë shtyllave që kanë të bëjnë me transformimin e sistemit



shëndetësor në Republikën e Kosovës. Po ashtu, ministri

Latifi vëmendje të posaçme i ka dhënë edhe

funksionalizimit sa më të shpejtë të Qendrës së Traumës, njëherësh zhvillimit të sistemit të traumës dhe emergjencës. Një çështje e rëndësishme, për të cilën ministri Latifi ka diskutuar me të pranishmit në këtë seminar, ishte edhe lista e pritjeve të pacientëve jo vetëm në Klinikën e Ortopedisë, por edhe për listën e pritjeve edhe në spitalet rajonale të Kosovës. Për këtë çështje ministri Latifi ka thënë se ka kërkuar që lista e pritjes të

zvogëlohet sa më shpejt. Ai ka thënë se është shumë i interesuar dhe është duke punuar fort që kjo listë e pritjes të zvogëlohet në këtë klinikë dhe në spitalet rajonale dhe pacientët ta marrin shërbimin e duhur pa pritje. Në këtë seminar kanë marrë pjesë shumë profesionistë shëndetësorë të fushës së ortopedisë, ku është diskutuar edhe për problematika të tjera profesionale të fushës së ortopedisë.

651 raste aktive me Covid-19

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 20 MARS - Ministria e Shëndetësisë, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, ka njoftuar të dielën se pas 1 058 testeve, 31 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me

virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të dielën janë shëruar 36 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarave është 223 346.

Në total numri i rasteve aktive është 651.

Shërbimi Spitalor Klinik dhe

Universitar i Kosovës ka njoftuar se 17 pacientë nga Covid-19 janë duke u trajtuar në ShSKUK. Prej tyre 14 pacientë janë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 3 të tjerë që kanë rezultuar negativë, por që vazhdojnë të jenë të trajtim mjekësor.

Me oksigjenoterapi janë 9

pacientë, kurse në Mjekim Intensiv janë të shtrirë 2 pacientë. Në 24 orët e fundit janë dhënë 118 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 819 579 doza të vaksinës. Deri më sot 819 255 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

AUV-i ndan 420 mijë euro për identifikimin e qenve endacakë

PRISHTINË, 20 MARS - Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë (AUV) ka hapur tender për identifikimin dhe regjistrimin e qenve me pronar në territorin e Republikës së Kosovës. Vlera e parashikuar për kontratë është 420 mijë euro, ndërsa kohëzgjatja është paraparë të jetë 12 muaj. “Faktorët të cilët do të merren parasysh gjatë riezaminimit janë

kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktues sepse çmimi është i njëjtë për të gjitha komunat i caktuar”, ka njoftuar AUV-i.

Kriter për dhënie të kontratës është caktuar çmimi më i ulët.

Afati për dorëzimin e tenderëve për operatorët ekonomikë të interesuar të ofertojnë është shkurtuar dhe AUV-i tregon arsyet për

këtë. “Dorëzimi i ofertave shkurtohet për arsye si shkak i qenve me pronarë po ndodh që të rritet edhe numri i qenve endacakë kështu që si autoritet kontraktues jemi të detyruar që të shpallim këtë tender me afat të shkurtuar”, ka njoftuar AUV-i.

Data 4 prill 2022 është afati i fundit për pranimin e tenderëve.





FATURA E MUAJIT MARS ME TARIFA TË REJA, KESCO SHPJEGON SI DO TË LLOGARITET ÇMIMI

Fatura e rrymës me tarifa të reja

Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) ka njoftuar se në bazë të vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji faturat e muajit mars do të njehsohen plotësisht me tarifa të reja. Sipas KESCO-s, konsumi do të ndahet në dy blloqe, 0-800kWh dhe më i lartë se 800kWh dhe në dy intervale ditore, përkatësisht ditë e natë

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 MARS - Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) ka njoftuar se faturat e muajit mars do të njehsohen plotësisht me tarifa të reja në bazë të vendimit të marrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Sipas KESCO-s, konsumi do të ndahet në dy blloqe, 0-800kWh dhe më i lartë se 800kWh dhe në dy intervale ditore, përkatësisht ditë e natë. "Tashmë dihet se konsumi në bllokun e parë prej 0-800kWh do të faturohet me të njëjtat tarifa, ndërsa konsumi mbi 800kWh do të faturohet me tarifa të reja. Pra, me tarifa të rritura do të paguhet vetëm

pjesa mbi këtë shpenzim. Nëse një konsumator ka shpenzuar gjithsej 900kWh, atëherë ai do të pagujë 800kWh me bllokun e parë, ku çmimet janë të pandryshuara dhe 100kWh me tarifën e lartë, të dyja të ndara edhe brenda konsumit ditë/natë", thuhet në njoftimin e KESCO-s.

Në faturën e konsumatorit do të shënohet përlllogaritja e parë me A1/B1, që përfaqëson tarifën e lartë, në bllokun deri në 800kWh. "Do të llogariten atëherë sa ka shpenzuar kryesisht gjatë ditës, që në stinën e dimrit është nga ora 7:00 e mëngjesit deri në orën 22:00. Ndërsa shpenzimet e bëra nga konsumatorët pas orës 22:00 deri në orën 7:00 paraqiten me kodin A2/B1. Kjo paraqet tarifën e ulët, që është bindshëm më e lira në Evropë

dhe ndër më të lirat në botë. Konsumi nga 801kWh e tutje në tarifën e lartë, shembull gjatë ditës do të shënohet me A1/B2, ndërsa konsumi në tarifën e ulët shënohet me kodin A2/B2. Pas procesit të leximit, konsumi për bllok do të llogaritet me çmimet përkatëse. Fatura përfundimtare do të kalkulohet duke shtuar edhe tarifën fikse, që për konsumatorët e amvisërisë është 1.74 euro dhe TVSh-në në shumën 8 për qind", thekson KESCO.

Kompania tregon se mbi 78 për qind e konsumatorëve nuk do të preken fare nga rritja e tarifave. "Sa iu përket atyre të cilët e kalojnë bllok-tarifën, KESCO apelon që ta kursejnë maksimum për t'ia lehtësuar barrën vetes dhe sistemit elektroenergetik të vendit në këtë kohë krize, kur çmimet në

tregun ndërkombëtar kanë arritur shifra marramendëse", ka njoftuar kompania.

Me pesë vota për dhe asnjë kundër Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë ka marrë vendim për shtrenjtimin e tarifës së energjisë elektrike për konsumatorët që shpenzojnë më shumë se 800 kW në muaj. Për shtrenjtimin e energjisë elektrike janë mbajtur disa protesta.

Ndërkaq Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar për vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për tarifën e reja të energjisë elektrike. Sipas opozitës, ky vendim nuk është i pavarur pasi ka qenë në sinkronizim të plotë në mes të Qeverisë së Kosovës dhe ZRRE-së.

Avokati i Thaçit, Gregory Kehoe: Gjatë punës time 30-vjeçare nuk kam parë kaq shumë redaktime në dokumente



PRISHTINË, 20 MARS - Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, ka thënë se gjatë punës së tij 30-vjeçare nuk ka parë kaq shumë redaktime në dokumente. Ai ka rrëfyer vështirësitë me të cilat po ballafaqohet mbrojtja për shkak të redaktimeve në dokumentet e aktakuzë. Sipas tij, kjo e ka vështirësuar punën e mbrojtjes që të kuptojë se çka prokuroria po tenton të vërtetojë. “Nëse shikohet në aktakuzë, aty ka të përfshira pretendime të ndryshme dhe kur jepet mbështetja në ato pretendime, informacioni

është i redaktuar. E bën të pamundur në disa instanca që të hetohen ato çështje, çka ne po mundohemi të bëjmë. Pra, a e pengon hetimin, a e pengon mbrojtjen tonë? Absolutisht, kategorikisht. Dhe prapë nuk kam parë ndonjëherë nivelin e këtyre redaktimeve siç e kam parë në këtë rast. Dhe e them këtë në dy anët e ekuacionit sepse unë kam punuar në zyrën e prokurorit fillimisht në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë dhe kjo nuk është bërë asnjëherë, sigurisht jo në këtë

nivel”, ka thënë ai për “Betimi për Drejtësi”. Këto redaktime, sipas tij, po e pengojnë mbrojtjen në hetime, edhe për dhënien e alibisë për klientët e tyre. “Ju e dini, presidenti Thaçi gjatë vitit 1998 dhe sigurisht një pjesë të hershme të vitit 1999 ka qenë duke udhëtuar në Evropë dhe vende të tjera për të biseduar me liderë të ndryshëm botërorë lidhur me përpjekjet për paqe, para Rambujesë dhe sidomos pas konferencës së Rambujesë në shkurt të vitit 1999. Pretendimet që janë në

aktakuzë përfshijnë një numër ngjarjes që supozohet që ndodhën në Kosovë gjatë vitit 1999, por ata nuk na japin datën dhe nuk na tregojnë se kush në fakt ishte i përfshirë”, thotë Kehoe. Avokati Kehoe thotë se pyetja është si do të parashtrijë mbrojtja alibi kur nuk i di datat, kur prokuroria pretendon se ndodhën këto ngjarje. “A ishte presidenti në Kosovë, a ishte në Shqipëri apo ishte në ndonjë numër të shteteve në Evropën Perëndimore? Pra, përgjigjja është se e paragjykon hetimin nga ana e mbrojtjes dhe disa

informacione ne nuk do t'i marrim deri para fillimit të gjyqimit dhe disa informacione për dëshmitarë nuk do t'i marrim derisa të hyjmë në gjykim”, ka thënë ai. Diskutimet për redaktimet e tepërta në aktakuza, vonesat për nxjerrjen e provave, për nxjerrjen e shumë provave përnjëherë, dhe vonesat në përkthime të shkresave jo rrallëherë kanë përfunduar në akuza dhe ofendime për trajtim jo të barabartë në mes të prokurorisë dhe mbrojtjes gjatë zhvillimit të seancave pranë kësaj gjykate.

Trashëgimia kulturore, drejt shkatërrimit

PRISHTINË, 20 MARS - Në Kosovë aktualisht janë të listuara rreth 1 600 asete që konsiderohen të rëndësishme për trashëgiminë kulturore.

Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dominohet kryesisht nga asete arkitekturore dhe arkeologjike. Shumë prej tyre me vështirësi janë duke i mbijetuar shkatërrimit.

Sipas Fondacionit Kosovar “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” (CHwB Kosovo), në Kosovë, nga viti 2018 deri më 2021, janë shkatërruar tërësisht nëntë objekte që kanë qenë të vendosura në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2020-2021.



Sipas këtij fondacioni, dhjetëra objekte të tjera që përfaqësojnë vlera të rëndësishme arkitekturore janë në prag të shkatërrimit.

Në Kosovë ekziston edhe një listë e aseteve të Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përhershme, e cila përmban 23 asete - në mesin e tyre: Manastiri

i Deçanit, Manastiri i Graçanicës, Patrikana e Pejës, Kalaja e Prizrenit e Xhamia e Sinan Pashës. “Radio Evropa e Lirë” ka vizituar

disa prej këtyre objekteve në qytete të ndryshme të Kosovës e që, sipas njohësve të trashëgimisë kulturore, “i kanë ditët e numëruara”.

Konfiskohen dy mijë kilogramë mjaltë të kontrabanduar në Debelde

PRISHTINË, 20 MARS (ER) - Njësisia patrulluese e policisë kufitare e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit-Zhegër të dielën rreth orës 11:30 ka parandaluar një rast të kontrabandës me

mallra. Në pjesën malore të fshatit Debelde është hasur një furgon ngjyrë e bardhë në të cilin kishte 2 000 kilogramë mjaltë. Dyshohet se drejtuesi i automjetit kishte

shfrytëzuar rrugët malore ilegale për ta kontrabanduar mjaltin nga Maqedonia Veriore në Kosovë. Drejtuesi i automjetit, duke shfrytëzuar terrenin malor, ka arritur të ikë,

ndërsa automjeti dhe ngarkesa janë konfiskuar. Rasti do të trajtohet në bashkëpunim me organet e drejtësisë, ndërsa automjeti dhe ngarkesa do të dorëzohen në Doganën e Kosovës.



Në Prizren gjenden mbetje mortore, s'dihet nëse i takojnë luftës së fundit në Kosovë

PRIZREN, 20 MARS - Gjatë gërmimeve për të hapur një varr në varrezat myslimane në lagjen "Tusus" të Prizrenit nga punëtorët për hapjen e varrezave është rastisur në një mbetje mortore të mbështjellë me rroba dhe batanije e për të cilën nuk dihet nëse i takon periudhës së luftës së fundit në Kosovë.

Udhëheqësi i Njësisë së Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Kushtrim Gara, ka thënë se në lidhje me këtë rast është herët të tregohen hollësitë, derisa ka shtuar se janë duke pritur konfirmimin e

mjekësisë ligjore për ta përcaktuar periudhën së cilës i takojnë këto mbetje mortore. "Jemi njoftuar nga mjekësia ligjore dhe policia për hetimin e krimeve të luftës për gjetjen e eshtrave në hapësirat e varrezave të qytetit të Prizrenit, saktësisht në lagjen 'Tusus'. Është e rëndësishme të përmendet fakti se dje në mëngjes ka dalë lajmi se është hasur në eshtra dhe gjatë ditës është bërë një trajtim me shumë prioritet nga ekspertët ligjorë, Instituti i Mjekësisë Ligjore, por edhe kolegët nga sektori i hetimeve për krime të luftës e

kanë hetuar rastin për shkak të ndjeshmërisë dhe kuptohet për shkak të familjarëve. Eshtrat janë dërguar për ekzaminime të mëtutjeshme në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Është herët të dihen hollësitë për këtë rast derisa të përfundojnë ekzaminimet e hollësishme të mjekut ligjor, përfshirë edhe konfirmimin nëse eshtra iu përkasin viktimave të luftës", ka thënë ai.

Gara thotë se hapësira e varrezave të qytetit të Prizrenit është trajtuar në vazhdimësi përgjatë viteve të fundit, por deri në përfundim të hetimit të këtij rasti do të duhen disa ditë.



Diplomojnë liderët e rinj nga kontingjenti i nënoficerëve të FSK-së



PRISHTINË, 20 MARS (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka njoftuar se në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes kanë diplomuar liderët e rinj nga kontingjenti i nënoficerëve të FSK-së.

Ai në "Facebook" ka shkruar se me programin mësimor të bazuar në modelin e sistemit arsimor të ushtrisë amerikane, kursantët kanë zhvilluar aftësitë profesionale. "Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes diplomojnë liderët e rinj nga kontingjenti i nënoficerëve të FSK-së. Me program mësimor të bazuar në modelin e sistemit arsimor të ushtrisë amerikane, kursantët tanë zhvilluan njohuritë dhe aftësitë profesionale të udhëheqjes së njësisë në teatrot e operacioneve në nivelin taktik. Forca drejt sukseseve të radhës. Ne, së bashku me aleatët tanë, jemi të pandalshëm, të pathyeshëm dhe të pakthyeshëm", ka shkruar Mehaj.

Stina e pranverës në Kosovë vjen me ngritje të temperaturave

PRISHTINË, 20 MARS (ER) - Stina e pranverës në Kosovë do të vijë me ngritje të temperaturave në vendin tonë. Sipas "Prishtina Weather", nga dita e hënë në Kosovë do të ketë përmirësim të motit. "Mot stabil e kryesisht me diell në ditët e para të pranverës. Fillimisht ngrica në orët e mëngjesit, nga dita e enjte më butë. Fushat anticiklonike do të dominojnë në hapësirat e kontinentit evropian edhe gjatë javës së parë të pranverës, që zyrtarisht fillon

sot më 20 mars, në orën 16:33, në hemisferën veriore. Nën këto kushte do të mbajë mot stabil, kryesisht me diell. Në ditët e para të javës paraqiten edhe vranësira kalimtare, megjithëse pa ndonjë mundësi për të reshura. Gjithashtu, orët e mëngjesit mbeten të ftohta e me ngrica, e nga dita e enjte do të kemi mot më të butë", ka bërë me dije "Prishtina Weather".

Deri në fund të javës pritet që temperaturat të arrijnë deri në 17 gradë celsius.

"Temperaturat me tendencë të rritjes, minialet nga -5C, ditën e hënë rriten edhe në 2C ditën e premte, e maksimalet nga 7C e 10C ditëve të para, kapin vlera prej 15C e 17C, ditën e enjte dhe të premte. Erërat fryjnë kryesisht nga verilindja mesatare dhe mesatarisht të fuqishme 4-13m/s, të martën me hove edhe deri në 15m/s. Shtypja atmosferike mbetet në vlera shumë të larta, megjithëse me tendencë të rënies", ka njoftuar "Prishtina Weather".



Për një metër katror deri në 200 euro më shtrenjtë banesat në Kosovë

PRISHTINË, 20 MARS - Pas rritjes së kostos së ndërtimit është rritur edhe çmimi i një metri katror të banesave në Kosovë, thotë kryetari i Shoqatës së Ndërtimtarëve të Kosovës, Faton Hoxha. Sipas të dhënave që ka ai, çmimet e materialeve ndërtimore janë rritur gjatë muajit të fundit mbi 20 për qind. Rritje kanë pësuar edhe çmimet e prodhimeve ushqimore, naftës, benzinës dhe shërbimeve të tjera.

Për këtë gjendje është fajësuar lufta që ka nisur Rusia në Ukrainë, nga 24 shkurti, dhe trazirat në tregjet që e kanë pasuar atë. "Pas fillimit të luftës në Ukrainë kemi një ngritje deri në 40 për qind [të çmimit] të hekurit. [Çmimi] i çimentos është 80 për qind më i lartë se në vitin e kaluar. Këto janë produkte bazë të ndërtimit, por rritje kanë pësuar edhe materialet e tjera ndërtimore", thotë Hoxha për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, një metër katror i një banese në Fushë-Kosovë ka arritur në 650 euro e më shumë, nga 500 sa ka

qenë vitin e kaluar.

Fushë-Kosova, e cila ndodhet vetëm gjashtë kilometra larg Prishtinës, ka ndër çmimet më të ulëta në treg, thonë në Shoqatën e Ndërtimtarëve të Kosovës.

Sali Murataj, banor i Prishtinës, thotë se është interesuar të blejë banesë në kryeqytet.

Rritja mund të mos ndalet me kaq

Çmimet kanë qenë në trend të rritjes edhe para shpërthimit të luftës në Ukrainë. Pandemia e koronavirusit, e cila ka nisur në vitin 2020, ka shkaktuar çrregullime në tregje, që më pas kanë rezultuar me rritje çmimesh.

Pronari i kompanisë ndërtimore "Elsa", Brahim Selimaj, thotë se këto dy ngjarje kanë rritur skajshmërisht koston e ndërtimit. Sipas tij, metri katror i banesave është shtrenjtuar për 200 euro krahasuar me vitin e kaluar. Rritja mund të mos ndalet këtu, thotë ai. "Çmimet mund të rriten edhe më shumë. Nuk dihet



se si do të jetë trendi, pasi Kosova nuk ka prodhime të veta dhe është e varur nga importi", thotë Selimaj për "Radion Evropa e Lirë".

Kosova është importuese e pothuajse të gjitha materialeve ndërtimore dhe çdo ndryshim i çmimeve në botë ndikon edhe në

Kosovë.

Në vitin 2021, Kosova, sipas të dhënave nga Doganat, ka importuar material ndërtimor në vlerë mbi 460 milionë euro. Materialet ndërtimore importohen kryesisht nga fqinjët: Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, por edhe nga vende të tjera.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, kostoja e ndërtimit në Kosovë ka shënuar rritje për 16 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Vetëm materialet ndërtimore, sipas ASK-së, janë shtrenjtuar për mbi 20 për qind.

Tërheqja e kursimeve pensionale, Trusti: Ne kryejmë përgjegjësitë tona ligjore

PRISHTINË, 20 MARS - Kriza e krijuar nga rritja enorme e çmimeve në vend si rrjedhojë e luftës në Ukrainë ka shtyrë Partinë Demokratike të Kosovës që të propozojë një tërheqje deri në 30 për qind të kursimeve në Fondin Pensional të Kursimeve të Kosovës (Trusti).

Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, më 9 mars ka dorëzuar në Kuvendin e Kosovës Projektligjin për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fondet Pensionale. Anëtarët ende nuk dihet se kur do të shqyrtohet ky projektligj në Kuvend, zyrtarët e Trustit janë deklaruar se janë të gatshëm për këtë proces në rast se miratohet.

Zëdhënësi i Trustit, Jeton Demi, ka thënë se Fondi e ka për mandat t'i administrojë dhe menaxhojë kontributet pensionale deri në pensionimin e kontribuuesve. "Ne duhet t'i kryejmë të gjitha përgjegjësitë tona ligjore. Mandati i institucionit është të administrojë dhe menaxhojë kontributet pensionale derisa

kontribuuesit dalin në pension. Brenda këtij fushëveprimi ne i kryejmë obligimet tona ligjore nga institucionet të cilat marrin vendime për kornizën dhe ambientin në të cilin veprojmë. Brenda këtij fushëveprimi, brenda këtij mandati, ne mund t'i komentojmë dhe japim vlerësimet tona. Jashtë këtij mandati nuk është në detyrën tonë të gjykojmë, t'i komentojmë opinionet apo vlerësimet dhe qëndrimet e individëve, të organeve apo institucioneve të tjera", thotë Demi për "KosovaPress".

Deri tash në mbështetje të këtij propozimi të bërë nga ana e deputetit Haxhiu duket të jenë vetëm deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), jo edhe të atyre nga LV-ja dhe LDK-ja.

Në anën tjetër, qytetarët janë për dhe kundër tërheqjes së mjeteve të Trustit. Qytetari Fatmir Murati u pajtua që qytetarët kanë nevojë për tërheqjen e trustit, e bllokimin e trustit e konsideroi hajni.



Edhe Adriatik Krasniqi tha se është pro tërheqjes së mjeteve pasi që, sipas tij, do t'u ndihmonte qytetarëve për të dalë nga kriza.

Ndërsa Destan Mjekiqi ishte kundër kësaj ideje pasi, që sipas tij, ato mjete duhet të ruhen për kohën e pleqërisë.

Kriza në tregjet ndërkombëtare ka bërë që të bie vlera e

investimit në kthim e Trustit rreth 4 për qind ose 90 milionë euro. Trusti aktualisht ka rreth 700 mijë kontributpagues me një fond rreth 2.3 miliardë euro, 78 për qind prej tyre të investuar në tregjet ndërkombëtare.

Kujtojmë se kontributpaguesit 10 për qind të kursimeve i kishin tërhequr në fund të vitit 2020. Në

atë kohë nga Trusti ishin tërhequr rreth 200 milionë euro nga mbi 420 mijë kontributpagues.

Për shkak të rënies ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19, ajo tërheqje ishte bërë pas miratimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike, që mundëson rimbursimin e atyre mjeteve nga qeveria prej vitit 2023.

Si do të përfundojë lufta e Rosisë kundër Ukrainës?

Nga Lawrence J.KORB & Stephen CIMBALA
"National Interest"

Lufta e Rosisë kundër Ukrainës, ka hyrë që tani tek ironitë më të mëdha në histori. Historia tregon se luftërat fillojnë sepse udhëheqës shtetesh apo komandantët e tyre, besojnë në të paktën 3 ide: së pari, që lufta do të jetë relativisht e shkurtër; së dyti, që ajo luftë do të përfundojë me fitoren e tyre; dhe së treti, që kostoja e luftës, sa i përket viktimave ushtarake dhe civile, dhe humbjet ekonomike, do të jetë relativisht e vogël në krahasim me përfitimet e pritshme.

Për më tepër, vlerësimet mbi qëllimet dhe aftësitë e armikut, janë shpeshherë të turbullta, dhe të bazuara në informacione të vjetruara ose interpretime të njëanshme. Në rastin e Rosisë, Car Nikolla II autorizoi në vitin 1904 nisjen e një lufte kundër Japonisë, me shpresën se kjo e fundit do të mposhtej me shpejtësi në tokë dhe në det.

Por humbja e papritur e Rosisë, shkaktoi revolta të mëdha në Shën Petersburg në vitin 1905. Edhe pse kryengritja u shtyp, ajo nxori në pah brishtësinë e regjimit. Në vitin 1917, në kulmin e problemeve që kishte shkaktuar Lufta e Parë Botërore, ajo u rrëzua. Së pari, pas abdikimit të Carit nga fronti në favor të qeverisë Kerensky, dhe pastaj gjatë Revolucionit Bolshevik të nëntorit të atij viti. Vladimir Putin nuk është Nikolla II. Deri në fillim të këtij viti, ai e kishte vënë theksin tek ajo që ekspertët perëndimorë e kanë quajtur "lufta në zonën gri" ose "lufta kufitare", në të cilën fuqia ushtarake përdoret për të mbështetur objektivat politike dhe anasjelltas.

Objektivat e tij kryesore ishin destabilizimi i ish-republikave sovjetike, dhe krijimi i enklavave pro-ruse, si në Gjeorgji në vitin 2008, dhe në Ukrainë në vitin 2014. Përdorimi i forcës nga Rusia ishte i kufizuar, dhe ndonjëse ndonjëherë ishte në një ofensivë taktike, Moska mbeti në mbrojtje në raport me synimet e saj strategjike. Synimi ishte të kundërshtojë perëndimorizimi i hapësirës ish-sovjetike në Evropë, dhe rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla të dominuar nga SHBA-ja, që sipas pikëpamjes së Putinit e vendos Rusinë në një pozitë të disavantazuar. Putini e ka shprehur hapur zhgënjimin e tij me zgjerimin e NATO-s. Dhe frika e përhapjes së



"revolucioneve shumëngjyrëshe" në Rusi, po e nxiste atë në mënyrë të qëndrueshme drejt krijimit të një ushtrie ruse më profesionale dhe më të aftë. Në vitin 2007, Putin i tronditi pjesëmarrësit në Konferencën e Sigurisë në Mynih, duke deklaruar publikisht se ishte koha që një strukturë e fuqisë ndërkombëtare "unipolare" e dominuar nga SHBA-ja, t'i linte vendin një bote shumëpolare, e cila përfshinte Rusinë midis fuqive të saj të mëdha.

Lufta e Rosisë me Gjeorgjinë në vitin 2008, aneksimi i Krimesë dhe destabilizimi i Ukrainës Lindore në vitin 2014, paralajmëruan ardhjen e erërave të pafavorshme. Në vitin 2018, Putin e përdori fjalimin e tij në parlamentin rus për ta njohur botën me armët e avancuara, përfshirë raketat hipersonike me energji bërthamore.

Pastaj pasuan disa stërvitje ushtarake të profilit të lartë, ku merrnin pjesë edhe trupat kineze.

Në pranverën dhe verën e viti të kaluar, Rusia mobilizoi forca të mëdha në kufi me Ukrainën. Pritshmëritë e Rosisë për një fitore relativisht të shpejtë dhe me kosto të ulët në Ukrainë, bazoheshin në vlerësimet e tyre të njëanshme të aftësive ushtarake të Ukrainës dhe tek nënvlerësimi i leadershipit të saj.

Dikur Volodymyr Zelenskyy ishte njeriu më qesharak në Ukrainë. Papritmas ai u

shndërrua në një Einston Churchill të Evropës Lindore, duke udhëhequr rezistencën e fortë të vendit të tij, dhe duke e mundur Rusinë në luftën e informacionit. Në vend se të arratisesh në një vend tjetër të sigurt, siç priste Putin, Zelenskyy u shndërrua në një simbol kombëtar, ndërsa komunikonte me udhëheqësit e NATO-s dhe të tjerët jashtë Ukrainës.

Dhe sot Rusia po sulmohet nga të gjitha vendet e botës, pjesërisht si rezultat i taktikave të saj të ngathta të dezinformimit në stilin e vjetër sovjetik, dhe pjesërisht për shkak të gatishmërisë së saj për të kryer masakra ndaj civilëve.

Në dallim nga epoka sovjetike, kamerat e telefonave celularë filmojnë sot çdo veprim në kohë reale, duke i zhvlerësuar deklaratat e zyrtarëve rusë. Shërbimet sekrete amerikane, i de-klasifikuan me shpejtësi provat e dezinformative ruse, duke i bërë ato publike edhe në mediat globale.

Brenda një jave apo më shumë pas pushtimit, Rusia e kishte humbur tashmë luftën e informacionit të imazheve dhe memeve, teksa efekti i sanksioneve ekonomike të vendosura nga qeveritë, u rëndua nga poshtërimi i përshkrimi të liderëve rusë si kriminelë lufte në mediat e gjithë botës.

Lufta e Putinit u bllokua që në fillim të marsit, për shkak të performancës së dobët të ushtrisë ruse, në krahasim me pritshmëritë e saj. Reformat

ushtarake të Rosisë në vitet 2008-2012 por dhe më tej, synonin të prodhonin më shumë forca të kombinuara të armëve të lëvizshme dhe vdekjeprurëse.

Po ashtu kishte një numër më të madh ushtarësh me kontratë, krahasuar me rekrutët, së bashku me armë dhe sisteme të përmirësuara të komandës dhe kontrollit. Por për habinë dhe zhgënjimin e Putin, ofensiva tokësore e Rosisë nga Bjellorusia ngeci përgjatë një kolone furnizimi mbi 60 km të gjatë, që lëvizi me ritmin e kërmillit krahasuar me objektivat e saj.

Ndërkaq nuk ishin të rralla raportet mediatike për ushtarë të pakënaqur midis forcave tokësore ruse. Pas 2 javë luftimesh, Rusia nuk e kishte vendosur ende nën kontroll hapësirën ajrore. Përballë këtij ngërçi ushtarak, Putin i shtoi sulmet ruse me raketa dhe ajrore kundër civilëve dhe strukturave urbane, duke sulmuar spitalet, dhe duke synuar të frikësonte udhëheqjen ukrainase dhe popullsinë civile.

Por as kjo taktikë nuk ka gjasa të ketë sukses. Sipas të gjitha gjasave, më shumë sulme ndaj civilëve, vetëm sa po e rritin izolimin politik global, dhe dëmet ekonomike të Rosisë. Putinsdukej i vendosur ta rrëzonte regjimin në Ukrainë dhe të negocionte ngritjen e një qeverie-kukull pas luftës.

Ndaj nuk duhet të përjashtohet mundësia e një

konflikti që zgjat për shumë javë apo edhe muaj. Po si do të përfundojë kjo luftë? Fatkeqësisht, për momentin ka pak arsye të jemi optimistë. Ekzistojnë një sërë rezultatesh të mundshme.

Së pari, mund të dominojë qasja agresive e Putins, dhe mund të kemi një Ukrainë kaotike nën kontrollin e tij nga distanca. Sipas skenarit të dytë, Putini nuk arrin të rrëzojë Zelenskyin dhe qeverinë e tij, ndaj mund ta zgjerojë luftën në vendet që ofrojnë ndihmë për Ukrainën, apo të përdorë armët bërthamore taktike për të shmangur poshtërimin nga disfata.

Së treti, mund të kemi një konflikt të stërzgatur që vazhdon për shumë javë ose muaj, nën hijen e përhershme të përshkallëzimit të mundshëm bërthamor. Së katërti, mund të kemi një ndjenjë rraskapitjeje nga të dyja palët, dhe një proces negociimi që prodhon një marrëveshje paqeje të pranueshme, të ndërmjetësuar nga vende si Turqia, Izraeli, Franca ose Gjermania. Opsioni i katërt duket të jetë më i miri. Por a mund të arrijmë atje? Shpresojmë që po, përpara se të ketë më shumë vdekje dhe shkatërrime.

Marrë me shkurtime

Shënim: Lawrence J.Korb, ish-ndihmës Sekretar i Mbrojtjes i SHBA. Stephen J.Cimbala, profesor i shkencave politike në Universitetit Shtetëror të Pensilvanisë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Fitojnë Ballkani e Drita, gabojnë Gjilani dhe Llapi

GJILAN, 20 MARS - Skuadra lidere e BKT Superligës, Ballkani, ka shënuar fitore para tifozëve të vet në duel me Drenicën, në kuadër të javës së 26-të. "Portokallezinjtë" nga Suhareka iu gëzuan fitores së 16-të në këtë edicion, me rezultat 2:0, duke u shkëputur 5 pikë ndaj ndjekësit më të afërt, Gjilanit. Blend Baftiu realizoi golin e parë në ndeshje në minutën e 40-të, derisa rezultatin përfundimtar e vendosi Lumbardh Dellova, në minutën e 59-të. Ballkani kryeson renditjen me 54 pikë, derisa Drenica renditet në pozitën e shtatë, me 32 pikë. Edhe ndeshja tjetër e ditës së sotme ka përfunduar me rezultat identik, ku Drita ka shënuar fitore ndaj Prishtinës në Gjilan (2:0). Rezultatit e zhblllokoj Marko Simonovski, në minutën e 48-të, derisa

fitoren e Dritës e vulosi Princ Balde, në minutën e 81-të, falë edhe reagimit jo të mirë të mbrojtësit Gledi Mici. Drita pas kësaj fitoreje ka 46 pikë në vendi e tretë, derisa Prishtina mbetet në kuotën e 32 pikëve në vendin e gjashtë. Dukagjini

| BKT SUPERLIGA | |
|----------------------|-----|
| Drita - Prishtina | 2-0 |
| Ballkani - Drenica | 2-0 |
| Llapi - Dukagjini | 1-2 |
| Malisheva - Gjilani | 0-0 |
| Feronikeli - Ulpiana | 2-2 |

| TABELA | |
|----------------|---------|
| 1. Ballkani | 54 pikë |
| 2. Gjilani | 49 |
| 3. Drita | 46 |
| 4. Llapi | 41 |
| 5. Malisheva | 33 |
| 6. Prishtina | 32 |
| 7. Drenica | 32 |
| 8. Dukagjini | 29 |
| 9. Ulpiana | 24 |
| 10. Feronikeli | 12 |



ka shënuar fitore tejet të rëndësishme si mysafir në stadiumin "Zahir Pajaziti", duke e mundur Llapi, me rezultat 2:1. Të dy golat për skuadrën e drejtuar nga Armend Dallku i ka shënuar sulmuesi me përvojë Ahmed Januzi. Golin e parë e realizoi në minutën e 10-të, derisa të dytin në minutën e 72-të. Në anën tjetër, llapjanët golin e

vetëm e shënuan në minutat shtesë të takimit, kur realizoi Latif Amadu. Kjo fitore ia mban edhe më tutje Dukagjinin në pozitën e 8-të, por tani me 29 pikë, duke ia rritur shpresat për t'iu shmangur zonës së rrezikshme. Ndërkohë, Gjilani nuk ka arritur të marrë më shumë se një pikë si mysafir i Malishevës, ndeshje e cila

është mbyllur pa gola. Të dyja palët kishin rastet e tyre për të shënuar, por nuk arritën të gjejnë rrugën e golit. Pas këtij barazimi skuadra e Arsim Thaqit renditet në pozitën e pestë, me 33 pikë, derisa gjilanasit e drejtuar nga Ismet Munishi mbesin në kuotën e 49 pikëve në pozitën e dytë. Pa fitues, por me gola ka përfunduar edhe ndeshja në Drenas, ku skuadra e fundit në renditje dhe pa shpresa për mbetje në elitë, Feronikeli, ka arritur ta ndalë Ulpianën, me rezultat 2:2. Golashënues të dyfishtë në këtë ndeshje ishin Ardi Qorri për Feronikelin (28', 79') dhe Goncalves Junior (34', 39') për skuadrën lipjanase.

Kuka nominohet për titullin 'Trajneri më i mirë evropian për femra'

PRISHTINË, 20 MARS - Trajneri më i suksesshëm kosovar, Driton Kuka, është nominuar për titullin "Trajneri më i mirë evropian i femrave" për vitin 2021. Kuka është nominuar nga Federata Evropiane e Xhudos. Trajneri i xhudos bëri të ditur se ceremonia e shpalljes së më të mirëve do të mbahet në fund të muajit prill. "Federata Evropiane e Xhudos më ka nominuar për titullin: Best European Womens Coach 2021. Po ndaj me ju emailin e ardhur për pjesëmarrje në Ceremoninë e më të mirëve që do mbahet gjatë Evropianit në Bullgari në fund të muajit prill!", ka shkruar Kukan në profilin e vet në "Facebook".



Peja fiton derbin ndaj Prishtinës, Trepça triumfon ndaj Prizrenit 16

PEJË, 20 MARS- Peja ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 89:78 (18:14, 20:28, 24:17, 27:19), në kuadër të javës së 23-të të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Vendasit e nisën ndeshjen për mrekulli, me një seri të jashtëzakonshme prej 15:2, por prishtinasit nuk dorëzohen, duke afuar shifrat në vetëm katër pikë, 18:14, sa përfundoi çereku i parë. Bardhekaltrit vazhduan me lojë të mirë në periudhën e dytë, ku për herë të parë kaluan në epërsi 32:34, pas 16 minutave lojë, ndërsa shkuan në pushim shkuan me shifrat 38:42. Perioda e tretë ishte shumë interesante, ku verdhezinjtë rikthehen shpejt, dhe kjo pjesë u karakterizua me shumë barazime e epërsi sa nga njëra skuadër, e sa nga tjetra, ku asnjëra nuk arrinte shkëputjen e madhe, ndërsa rezultati pas 30 minutash ishte 62:59. Megjithatë, në dhjetë minutat e fundit dhe



vendimtare, vendasit ishin më të mirë, duke krijuar epërsi deri në 14 pikë dhe e menaxhoi epërsinë deri në fund për të triumfuar me shifrat 89:78. Te Peja u dalluan Courtney Fells me 25 pikë, shtatë kërcime e gjashtë asistime, Calvin Godfrey me 18 pikë e dhjetë kërcime dhe Daniel Lekndreaj me 19 pikë e shtatë kërcime, kurse te Sigal Prishtina u dalluan Jan Palokaj me 17 pikë e pesë kërcime dhe Lejson Zeqiri me dhjetë pikë e tetë kërcime. Peja ka 15 fitore e shtatë humbje, kurse Sigal

Prishtina 11 fitore e 12 humbje. Trepça ka shënuar fitore në udhëtim ndaj Prizrenit 16 me rezultat 70:79 (9:23, 22:19, 17:25, 22:12), në xhiron e 23-të të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Mitrovicasit e nisën ndeshjen shumë më mirë, duke pasur epërsi prej dhjetë pikësh, 7:17, e më pas e ngritën epërsinë edhe më shumë, duke e fituar çerekun e parë 9:23. Epërsia më e lartë në pjesën e parë ishte 16 pikë për mysafirët, ndërkohë që vendasit bënë përpjekje

maksimale për të afuar rezultatin dhe ajo që arritën ishte deri në 11 pikë, 31:42. 'Xehetarët' ishin të vendosur për fitore dhe sërish në periudhën e tretë e ngritën epërsinë, në 17 pikë, 40:57, ndërsa në fund të kësaj pjese arritën epërsinë më të lartë, 48:57, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Në dhjetë minutat e fundit, prizrenasit tentuan rikthimin e madh, por vetëm arritën të ngushtojnë shifrat në 66:74, e më pas mitrovicasit e kontrolluan lojën, duke triumfuar me rezultat 70:79. Te Prizreni 16 u dalluan Darell Davis me 25 pikë e dhjetë kërcime dhe Xavier Cannefax me 23 pikë e pesë kërcime, ndërsa te Trepça u dalluan Mike Edwards me 19 pikë e 13 kërcime dhe Drilon Hajrizi me 14 pikë, 10 kërcime e gjashtë asistime. Prizreni 16 ka 13 fitore e nëntë humbje, kurse Trepça 16 fitore e shtatë humbje.

Barcelona turpëron Realin në 'El Clasico'

Madrid, 20 mars - Barcelona ka arritur një fitore spektakolare në shifrat 4-0 ndaj Real Madridit në "El Clasico" e luajtur në mitikun "Santiago Bernabeo". Pas një gjysmë ore lojë do të zhblllokohej dhe rezultati. Pas një

krosimi fantastik të Dembele nga krahu i djathtë, Aubameyang e ka të thjeshtë për ta dërguar topin në kuadrat me një goditje me kokë. Ky gol i dha zemër ekipit katalanas që 9 minuta më pas do të gjente dhe golin e dytë, por me një

goditje me kokë të mbrojtësit Araujo. Fillimi i pjesës së dytë do të ishte i gjithi për Barcelonën që do të gjente dy gola të shpejtë. Ferran Torres realizoi pas një kombinimi fantastik me Aubameyang. 4 minuta më pas sulmuesi spanjoll i

kthehu nderin bomberit nga Gaboni, i cili realizoi me parabolë. Dy sulmuesit falën dhe gola të tjerë ndaj një mbrojtje katastrofike të skuadrës së Ancelottit. Një fitore e madhe për Barcelonën që konfirmon formën fantastike në këtë



fazë të sezonit që i shih në vendin e tretë me 54 pikë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Andersson Group” SH.P.K. me pronar Hanife Andersson Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810065369 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Andersson Group” D.O.O. Hanife Andersson Gjilan donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810065369 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Andersson Group” L.L.C. Hanife Andersson Gjilan has come to the decision to quit its business: 810065369 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek **“REB BULLI”**, në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit: **044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



NJOFTIM

TRAFIKU URBAN SH.A njofton se me date 18.03.2022 mbyllet njoftimi i shpallur në gazetën ditore “Epoka e Re” me datën 01.03.2022 “ Shprehje Interesi për ofrimin e shërbimeve të marketingut”

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Veli Shatri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curi " Romaje.
- ▶ Emine Bobaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Deshmoret e Kabashit " Korishe.
- ▶ Nezir Morina shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Clirim Kastrati shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Valton Cafleshi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Ajser Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl X shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Dimitrije Krstic shpall te pavlefshme 2 dëftesat shmlt " 11 Marsi " Prizren.
- Lirigzon Gubetini shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- ▶ “Durguti-E” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810394792.
- ▶ Nakshije Maloku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1. 2. 3. 4 si dhe diplomën e shkollës së mesme të Bujqësisë “Arbëria” Gjilan.
- ▶ Nakshije Maloku shpall të pavlefshme dëftesat nga kl, 1 deri 8 të shkollës fillore “Selami Hallaqi” Gjilan.
- ▶ Shemsije Thaqi shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan.
- ▶ Shemsije Maloku shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme “Arbëria” Gjilan.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues